

UDHËZIM PËR VLERËSIM

VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.

DETYRA 1: Nxënësi/nxënësja* merr **1 pikë** nëse ka shkruar ose perfrazuar nga teksti i dhënë fjalitë: Në mesin e viteve 1970, Rubik mësoi dizajn në Akademinë e Arteve të Aplikuara në Budapest dhe u përpoq të gjente një mënyrë për t'ua paraqitur lëvizjen 3D studentëve të tij./ Ai e shikoi Danubin për një kohë të gjatë dhe mendoi për lëvizjen e ujit rreth zhavorrit dhe ky fenomen shërbeu si frymëzim për mekanizmin lëvizës të kubit. Për shkak të tentimit që studentëve t'u shfaqet lëvizja 3D. *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*

DETYRA 2: nxënësi merr **1 pikë** nëse e ka rrethuar saktë të gjitha pohimet: P, P, S.

DETYRA 3: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Qëllimi i lojës është të montohet kubi ashtu që secila anë të jetë njëngjyrëshe. *(dhe përgjigje të tjera të sakta).*

DETYRA 4: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar JO dhe ka shpjeguar zgjedhjen e tij: Kubi mund të montohet në disa mënyrë dhe një nga më e njohura është metoda e Fridrihit. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

Vërejtje:

1. Nxënësi merr 1 pikë nëse argumenton saktë, por nuk ka rrethuar as PO dhe as JO.
2. Nxënësi merr 0 pikë nëse ka rrethuar PO, pa marr parasysh saktësinë e argumentimit.

DETYRA 5: gjithsej **2 pikë:**

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar se është e domosdoshme që të di se si quhen anët e tij. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar se i mungon ana e mesme e cila quhet Middle ose M. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI SHKOLLOR 2021-2022

DETYRA 6: është rrethuar numri 2 – *Formula e Pagëzimit*

1 pikë

DETYRA 7: nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: lirikës

DETYRA 8: gjithsej **2 pikë:**

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka rrethuar 2- veriut
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka argumentuar përgjigjen nën A me të paktën dy fjalë që e vërtetojnë përgjigjen e saktë: tue kalue, tue bajtun etj.

DETYRA 9: gjithsej **2 pikë:**

- A) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka shkruar: Poeti kujton vendlindjen dhe fëmijërinë e hershme
- B) nxënësi merr **1 pikë** nëse ka ilustruar me vargje nga poezia periudhën e fëmijërisë dhe jetës modeste që mban mend poeti: tue hy në të shtatën vjetë/shkova me njerëzit e mij shtigjeve të malit....etj.

DETYRA 10: gjithsej **2 pikë:**

mbiemër (**1 pikë**)
epitet (**1 pikë**)

DETYRA 11: është rrethuar numri 3 – Krijimet e të kaluarës së hidhur

1 pikë

DETYRA 12: gjithsej **2 pikë:**

Vepra: *Bagëti e bujqësia* **1 pikë**

Autori: *Naim Frashëri* **1 pikë**

DETYRA 13: nxënësi merr **2 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

kërcejnë - folje
bukur - mbiemër
dallëndyshe – emër
një – numëror

Nxënësi merr 1 pikë për 3 përgjigje të sakta.

Nxënësi merr 0 pikë për 2 ose më pak përgjigje të sakta.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI SHKOLLOR 2021-2022

DETYRA 14: është rrethuar numri 3 – 16 - rrokësh
1 pikë

DETYRA 15: gjithsej **3 pikë**

- A) Nxënësi merr 1 pikë nëse ka shkruar: ndajfolje
B) nxënësi merr 2 pikë për përgjigje plotësisht të saktë:
rrënja – udhë
prapashtesa – tar
mbaresa – ët

Nxënësi merr 1 pikë për 2 përgjigje të sakta.
Nxënësi merr 0 pikë për 1 ose për asnjë përgjigje të saktë.

DETYRA 16: nxënësi merr **3 pikë** për përgjigje plotësisht të saktë:

VEPRA	EMRI DHE MBIEMRI I AUTORIT	PERSONAZHI KRYESOR
<i>Andrra e jetës</i>	Ndre Mjeda	Trina
<i>Tregtar flamujsh</i>	Ernest Koliqi	Hilush Vilëza
<i>Kështjella</i>	Ismail Kadare	Tursun Pasha
<i>Plaku dhe deti</i>	Ernest Heminguej	plaku Santiago; djaloshi Manolin

Nxënësi merr 2 pikë për 5 përgjigje të sakta.
Nxënësi merr 1 pikë për 4 përgjigje të sakta.
Nxënësi merr 0 pikë për 3 ose më pak përgjigje të saktë.

DETYRA 17: gjithsej **2 pikë**

Bagëti dhe bujqësi – poemë lirike
Si e gjeti Ago Jakupi rrugën e zotit - tregim
Romeo dhe Zhulieta - tragjedi

Nxënësi merr 1 pikë për 2 përgjigje të sakta.
Nxënësi merr 0 pikë për 1 ose për asnjë përgjigje të saktë.

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI SHKOLLOR 2021-2022

DETYRA 18: gjithsej **2 pikë**

e të tjera - *etj.*

për shembull – *p.sh.*

era e re – *e.r.*

Nxënësi merr 1 pikë për 2 përgjigje të sakta.

Nxënësi merr 0 pikë për 1 ose për asnjë përgjigje të saktë.

DETYRA 19: gjithsej **2 pikë:**

A) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka nënvizuar ose rrethuar fjalën
sociologjia

B) Nxënësi merr **1 pikë** nëse ka nënvizuar ose rrethuar fjalën
sypatrembur

DETYRA 20: Skema e vlerësimit të hartimit ***Dëshira ime është plotësuar***

Përmbajtja – 10 pikë

Kërkesa 1.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për dëshirat ose numëron disa nga dëshirat e tija.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 2.

Nxënësi merr 1 pikë nëse përmend dëshirën e madhe të tij.

Nëse shkruan për synime e tija për përmbushjen e dëshirës, merr 2 pikë.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 3 pikë.

Gjithsej 3 pikë

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI SHKOLLOR 2021-2022

Kërkesa 3.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan shkurt për përmbushjen e dëshirës së tij.

Nëse bën një përshkrim më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 4.

Nxënësi merr 1 pikë nëse përshkruan shkurt ndjenjat e veta/ndjenjat në momentin e realizimit të dëshirës.

Nëse bën një përshkrim më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.

Gjithsej 2 pikë

Kërkesa 5.

Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan se ka/nuk ka ndonjë dëshirë të madhe.

Gjithsej 1 pikë

Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë

Leksiku	Saktësia gjuhësore	Lidhshmëria	Struktura e tekstit
→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur 2 pikë	<u>GRAMATIKA</u> → respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës) 2 pikë <u>DREJTSHKRIMI</u> → respektimi i normës	→ renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij 1 pikë → s' është i	→ përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike 1 pikë

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI SHKOLLOR 2021-2022

<p>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, leksiku i varfër dhe përsëritja e shprehjeve</p> <p>pjesërisht e saktë</p> <p>1 pikë</p>	<p>drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>2 pikë</p> <p>Gjithsej 4 pikë</p> <p><u>GRAMATIKA</u></p> <p>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)</p> <p>pjesërisht e saktë</p> <p>- 1 pikë</p> <p><u>DREJTSHKRIMI</u></p> <p>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse,</p>	<p>lidhur në nivel të tekstit dhe pjesëve të tij</p> <p>0 pikë</p>	
---	--	---	--

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI
KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE
QERSHOR, VITI SHKOLLOR 2021-2022

	<p>respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)</p> <p>pjesërisht e saktë - 1 pikë Gjithsej 2 pikë</p>		
--	---	--	--